



## Izolimi i të burgosurve

*Pjesë nga raporti i 21-të i Përgjithshëm,  
publikuar në vitin 2011*

### Hyrje

53 Izolimi i të burgosurve është gjetur, në një formë a mënyrë, në çdo sistem të burgjeve. KPT-ja u ka kushtuar gjithmonë vëmendje të veçantë të burgosurve që i nënshtrohen izolimit të veçuar, sepse kjo mund të ketë efekt shumë të dëmshëm në shëndetin mendor, somatik dhe social të të burgosurit.<sup>1</sup>

Ky efekt i dëmshëm mund të jetë i menjëhershëm dhe të rritet sa më shumë që zgjat masa dhe sa më e papërcaktuar të jetë ajo. Treguesi më i rëndësishëm i dëmit që izolimi mund ta shkaktojë është norma dukshëm më e lartë e vetëvrasjeve në mesin e të burgosurve që i nënshtrohen izolimit sesa është në mesin e popullatës së përgjithshme të burgjeve. Është e qartë, pra, se izolimi në vetvete potencialisht ngre çështje në lidhje me ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor ose degradues. Përveç kësaj, mund të krijojë një mundësi për keqtrajtim të qëllimshëm të të burgosurve, larg nga vëmendja e të burgosurve të tjerë dhe e personelit .Prandaj, është në qendër të shqetësimeve të KPT-së dhe, në çdo vizitë, delegacionet kujdesen të intervistojnë të burgosur të izoluar në qeli, që t'ua ekzaminonjë kushtet e mbajtjes dhe të trajtimit si dhe t'i kontrollojnë procedurat për të vendosur mbi vendosjet e tilla dhe për rishqyrtimin e tyre .Në këtë seksion të Raportit të Përgjithshëm, KPT-ja përcakton kriteret që përdor gjatë vlerësimit të izolimit të veçuar. Komiteti beson se nëse ndiqen këto kriteret, duhet të jetë e mundur të reduktohet përdorimi i izolimit në minimumin absolut, për t'u siguruar që, kur përdoret në periudhën më të shkurtër të nevojshme kohore, ta bëjë secilin prej regjimeve të izolimit sa më pozitiv dhe të garantojë se janë vënë në vend procedura që përdorimin e kësaj mase ta bëjnë plotësisht të përgjegjshëm.

54. KPT-ja e përdor termin "izolim" në kuptimin sa herë që i burgosuri urdhërohet të mbahet i veçuar nga të burgosurit e tjerë, për shembull, si rezultat i një vendimi gjyqësor, si sanksion disiplinor i vendosur brenda sistemit të burgjeve, si një masë parandaluese administrative ose për mbrojtjen e të burgosurit në fjalë. Një i burgosur i vënë në një mase të tillë zakonisht do të mbahet vetëm; megjithatë, në disa shtete, mund të vendoset së bashku me një ose dy të burgosur të tjerë, dhe ky seksion zbatohet njëllor edhe për situata të tilla.

Sa i përket më konkretisht e izolimit të veçuar të të miturve, një praktikë për të cilën KPT-ja ka rezerva të forta, referimi duhet të bëhet edhe te komentet e bëra nga Komiteti në raportin e vet të 18-të.<sup>2</sup>

Ky seksion nuk zbatohet për izolimin e të burgosurve për arsye mjekësore, pasi arsyet për një masë të tillë janë të një natyre krejt të ndryshme.

<sup>1</sup> Prova nga hulumtimi për këtë është përmbledhur në "A Sourcebook on Solitary Confinement" nga Sharon Shalev (Mannheim Centre for Criminology, Londër 2008), në mënyrë elektronike në [www.solitaryconfinement.org](http://www.solitaryconfinement.org)

<sup>2</sup> Shih CPT/Inf (2008) 25, paragrafi 26.

## Parimet e përfshira

55. Izolimi i veçuar kufizon të drejtat tashmë shumë të kufizuara të njerëzve të privuar nga liria. Kufizimet shtesë të përfshirë nuk janë të pandara nga fakti i burgimit dhe prandaj duhet të justifikohen ndaras. Për të testuar nëse një imponim i caktuar i masës është i justifikueshëm, është e përshtatshme të aplikohen testet tradicionale të parashikuara në dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të zhvilluara nga praktika gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. PLANN i thjeshtë kujtesës i përmbledh këto teste.

(a) Proporcional: çdo kufizim i mëtejshëm i të drejtave të një të burgosuri duhet të lidhet me dëmin aktual apo potencial që i burgosuri ka shkaktuar ose do të shkaktojë me veprimet e veta (ose dëmet e mundshme të cilave u ekspozohet) në ambientin e burgut .Duke pasur parasysh se veçimi me izolim është kufizim i rëndë i të drejtave të një të burgosuri që përfshin edhe rreziqe të natyrshme për të burgosurin, niveli i dëmit aktual ose potencial duhet të jetë të paktën po aq serioz dhe në mënyrë të veçantë i adresueshëm vetëm në këtë mënyrë. Kjo reflektohet, për shembull, në shumicën e vendeve që kanë izolimin me veçim si sanksion vetëm për veprat më të rënda disiplinore, por parimi duhet të respektohet në të gjitha përdorimet e kësaj mase. Sa më gjatë që të vazhdohet masa, aq më e fortë duhet të jetë arsyeja për të dhe aq më shumë duhet të bëhet për t'u siguruar që ajo ta arrijë qëllimin e saj.

(b) I ligjshëm: dispozitat duhet të figurojnë në legjislacionin e vendit për secilin lloj të izolimit me veçim që lejohet në një shtet, dhe këto dispozita duhet të jenë të arsyeshme. Ato duhet t'i komunikohen në formë të kuptueshme të gjithëve që mund t'i nënshtrohen i saj. Ligji duhet të specifikojë rrethanat e sakta në të cilat mund të shqiptohet secila formë e izolimit me 0}veçim, personat të cilët mund ta vendosin, procedurat që duhet të ndiqen nga ata persona, të drejtën e të burgosurit të prekur për të bërë përfaqësime si pjesë të procedurës, kërkesat për t'u dhënë të burgosurve arsyet sa më të plota për vendimin (duke u kuptuar se në raste të caktuara mund të jetë e arsyeshme të mos shpalosen detaje të caktuara për arsye që lidhen me sigurinë, ose për t'i mbrojtur interesat e palëve të treta), shpeshësinë dhe procedurat e shqyrtimeve të vendimit dhe procedurat për ankesë kundër vendimit. Regjimi për secilin lloj të vetmisë duhet të përcaktohet me ligj, ku secili prej regjimeve diferencohen qartë nga njëra-tjetra.

(c) Përgjegjës: të dhëna të plota duhet të mirëmbahen për të gjitha vendimet për vendosjen e izolimit me veçim dhe të gjitha shqyrtimeve të vendimeve. Këto të dhëna duhet të evidentojnë të gjithë faktorët që janë marrë në konsideratë dhe informacionin në të cilin janë bazuar. Duhet të ketë edhe regjistër të mendimeve të të burgosurit ose refuzimit për të kontribuar në procesin e vendimmarrjes. Për më tej, të dhënat e plota duhet të mbahen për të gjitha bashkëveprimet me stafin, ndërsa i burgosuri ndodhet në izolim, duke përfshirë edhe përpjekjet e stafit për t'u angazhuar me të burgosurin dhe përgjigjet e të burgosurit.

(d) I nevojshëm: rregulla se lejohen vetëm kufizimet e nevojshme për kufizimin e sigurt dhe të rregullt të të burgosurit dhe kërkesat e drejtësisë, vlen njëlloj për të burgosurit që i nënshtrohen izolimit me veçim. Prandaj, gjatë izolimit në vetmi nuk duhet, për shembull, të ketë asnjë shlyerje automatike të të drejtave për vizita, thirrje telefonike dhe korrespondencë ose qasje në burimet që zakonisht janë në dispozicion për të burgosurit (si materiale leximi).Po ashtu, regjimi duhet të jetë mjaft fleksibil për të lejuar relaksimin e çdo kufizimi që nuk është i nevojshëm në rastet individuale.

(e) Mosdiskriminues: jo vetëm që duhet të merren të gjitha çështjet relevante në konsideratë në marrjen e vendimeve për të imponuar izolimit me vetmi, por duhet treguar kujdes edhe për t'u siguruar që çështjet e parëndësishme të mos merren parasysh. Autoritetet duhet të monitorojë përdorimin e të gjitha formave të izolimit për t'u siguruar që të mos përdoren në mënyrë disproporcionale, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, kundër një të burgosuri të veçantë ose grupeve të caktuara të të burgosurve.

## **Llojet e izolimit me vetmi dhe legjitimiteti i tyre**

56. Ka katër situata kryesore në të cilat përdoret izolimi me vetmi. Secila ka logjikën e vet dhe secila duhet të shihet ndryshe:

### **(a) Izolimi si rezultat i një vendimi gjyqësor**

Në shumicën e vendeve, gjykatat kanë fuqinë të urdhërojnë që personi në paraburgim (pra, i vendosur aty para gjykimit) të mbahet për një periudhë të caktuar në izolim, në interes të hetimit penal. Për më shumë, në disa vende, një periudhë e izolimit me vetmi është pjesë automatike e disa dënimeve të përcaktuara me legjislacion ose mund të urdhërohet nga një gjykatë si pjesë e dënimit.

Në lidhje me izolimin e urdhëruar nga një gjykatë si pjesë e kushteve të paraburgimit, është aksiomatike që mund të ketë justifikim, në një rast individual dhe në bazë të provave të mjaftueshme, për ta mbajtur një të paraburgosur të caktuar të ndarë nga të burgosurit e tjerë të caktuar, ose në rrethana edhe më të jashtëzakonshme, të burgosurit në përgjithësi, dhe në kufizimin e kontaktit të tij/saj me botën e jashtme. Kjo duhet të bëhet vetëm për t'u mbrojtur kundër një rreziku të vërtetë për administrimin e drejtësisë dhe duhet t'u nënshtrohet masave mbrojtëse të përcaktuara në paragrafin 57 më poshtë.

KPT konsideron se izolimi nuk duhet të imponohet - ose të jetë i imponueshëm me diskrecionin e gjykatës në fjalë - si pjesë e dënimit. Parimi përgjithësisht i pranuar se shkelësit dërgohen në burg si dënim, jo për tu denuar, duhet të kujtohet në këtë kontekst. Burgimi është dënim në vetvete dhe përkeqësimet potencialisht të rrezikshme të një dënimi me burg, si pjesë e dënimit nuk janë të pranueshme. Mund të jetë e nevojshme për një të burgosur të dënuar që t'i nënshtrohet, për një periudhë të caktuar kohe, një regjimi të izolimit me vetmi; megjithatë, vendosja e një regjimi të tillë duhet të mbetet te autoritetet e burgut dhe jo të bëhet pjesë e katalogut të sanksioneve penale.

### **(b) Izolimi si sanksion disiplinor**

Tërheqja e një të burgosuri nga kontakti me të burgosurit e tjerë mund të vendoset sipas procedurave normale disiplinore të përcaktuara me ligj, si dënim më i rëndë disiplinor. Duke njohur rreziqet e natyrshme e këtij sanksioni, vendet specifikojnë një periudhë maksimale për të cilën ai mund të imponohet. Kjo mund të ndryshojnë nga pak ditë deri në një muaj ose më shumë. Disa vende lejojnë drejtuesit e burgut të imponojnë një periudhë të caktuar maksimale, me mundësinë që një organ gjyqësor të imponojë një periudhë më të gjatë. Shumica e vendeve - por jo të gjitha - ndalojnë dënimet e njëpasnjëshme me izolim.

Duke pasur parasysh efektet potencialisht shumë të dëmshme të izolimit me vetmi, KPT-ja konsideron se parimi i proporcionalitetit kërkon të përdoret si dënim disiplinor vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe si masë e fundit dhe për periudhën më të shkurtër të mundshme. Trendi në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës është drejt uljes së periudhës maksimale të mundshme të izolimit me vetmi si dënim. KPT konsideron se periudha maksimale duhet të jetë jo më e lartë se 14 ditë për një vepër të caktuar, dhe mundësisht më e ulët.<sup>3</sup> Për më tej, duhet të ketë një ndalim të dënimeve disiplinore të njëpasnjëshme që rezultojnë me një periudhë të pandërprerë prej izolimit me vetmi e që tejkalojnë periudhën maksimale. Çdo vepër e kryer nga një i burgosur që ndjehet se kërkon sanksione më të rënda duhet të trajtohet nëpërmjet sistemit të drejtësisë penale.

---

<sup>3</sup> Periudha maksimale me siguri duhet të jetë më e ulët për të miturit.

### **(c) Izolimi administrativ me vetmi për qëllime parandalimi**

Ligji në shumicën e vendeve evropiane lejon për një vendim administrativ që të vendosë në izolim të burgosurit që kanë shkaktuar, ose vlerësohen se mund të shkaktojnë, dëm të rëndë për të tjerët ose që paraqesin një rrezik shumë serioz për sigurinë ose mirëqenien e burgut. Kjo mund të jetë shkurt deri në disa orë, në rastin e një incidenti të izoluar, ose për një periudhë prej disa vitesh në rastet që përfshijnë të burgosur të cilët konsiderohen si veçanërisht të rrezikshëm dhe vazhdojnë të paraqesin rrezik të menjëhershëm.

Ky është potencialisht lloji më i gjatë i qëndrueshëm i izolimit me vetmi dhe shpesh lloji me masat mbrojtëse procedurale më të pakta. Për këtë arsye është e rëndësishme që të ketë rregulla për t'u siguruar se nuk përdoret shumë lehtë (p.sh. si një përgjigje e menjëhershme ndaj çdo shkeljeje disiplinore në pritje të gjykimit), shumë gjerësisht, ose për periudha shumë të gjata. Prandaj, masat mbrojtëse të përshkruara në paragrafin 57 më poshtë duhet të ndiqen në mënyrë rigoroze.

### **(d) Izolimi për qëllime të mbrojtjes**

Çdo sistem i burgjeve ka të burgosur që mund të kërkojnë mbrojtje nga të burgosurit e tjerë. Kjo mund të jetë për shkak të natyrës së shkeljes së tyre, bashkëpunimit me autoritetet e drejtësisë penale, rivalitetit ndërmjet bandave, borxheve jashtë ose brenda burgut apo ndjeshmërisë së përgjithshme të personit. Ndërsa shumë të burgosur mund të menaxhohen në popullatën e përgjithshme të burgjeve në këto rrethana, rreziku për disa është i tillë që burgu mund ta kryejë vetëm detyrën e kujdesit për individët vetëm duke i mbajtur ata larg nga të gjithë të burgosurit e tjerë. Kjo mund të bëhet me kërkesën e vetë e të burgosurit ose me nxitjen e menaxhmentit kur është e nevojshme. Cilido procesi, fakti është mund të jetë shumë e vështirë për një të burgosur të hiqet nga mbrojtja për pjesën tjetër të dënimit - dhe ndoshta edhe për dënimet e mëvonshme.

Shtetet kanë detyrim të sigurojnë një mjedis të sigurt për ata që mbyllen në burg dhe duhet të përpiqen ta përmbushin këtë detyrim, duke lejuar sa më shumë ndërveprim shoqëror në mesin e të burgosurve, në përputhje me ruajtjen e rendit të mirë. Duhet të përdoret izolimi për qëllime të mbrojtjes vetëm kur nuk ka absolutisht asnjë mënyrë tjetër për të siguruar të burgosurin në fjalë.

## **Vendimi për vendosje në izolim: procedurat dhe masat mbrojtëse**

57. Për t'u siguruar se vetmia shqiptohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe për kohën më të shkurtër të nevojshme, çdo lloj i izolimit të vetmuar duhet të ketë procesin e vet të veçantë për zbatim dhe shqyrtim. KPT përshkruan këtu ato që i konsideron procese të duhura:

### **(a) Izolimi si pjesë e kushteve të paraburgimit**

Siç u tha tashmë, izolimi i personave në paraburgim duhet të përdoret vetëm me masë dhe kur ka prova të drejtpërdrejta në një rast individual se ekziston një rrezik serioz për administrimin e drejtësisë nëse i burgosuri në fjalë ndërvepron me të burgosur të caktuar ose të tjerët në përgjithësi. Vendimet e tilla duhet të bëhen në gjyq të hapur, me sa një gjykim sa më të arsyetuar, dhe të jenë të apelueshme veç e veç. Ato duhet të shqyrtohen edhe nga gjykata kompetente rregullisht për t'u siguruar se ekziston një nevojë e vazhdueshme për izolim.

### **(b) Izolimi si sanksion disiplinor**

Arsyeja për vendosjen e izolimit si dënim, dhe gjatësia e kohës për të cilën ai vendoset, duhet të dokumentohen plotësisht në procesverbalin e seancës disiplinore. Të dhënat e tilla duhet të jenë në dispozicion për menaxherët e lartë dhe organet mbikëqyrëse. Nuk duhet të ketë proces efektiv

apelimi që mund të rishikojë gjetjen e fajësisë dhe/ose dënimin në kohë për të bërë një ndryshim të tyre në praktikë. Një shoqërues i domosdoshëm i kësaj është disponueshmëria e gatshme e këshillave ligjore për të burgosurit në këtë situatë.

Të burgosurit që i nënshtrohen këtij dënimi duhet të vizitohen përditë nga drejtori i burgut ose ndonjë anëtar i menaxhmentit të lartë, si urdhri duhet dhënë për ta përfunduar izolimin me vetmi, kur ky hap kërkohet për shkak të gjendjes ose sjelljes së të burgosurit. Duhet të mbahet regjistri i vizitave të tilla dhe i vendimeve të ndërlydhura.

### **(c) Izolimi me vetmi administrativ për qëllime parandalimi**

Ky mund të rezultojë në shumë vendosje afatgjata nën izolim dhe vendimet administrative të përfshira janë shpesh të papërcaktuara; të dyja këto elemente përkeqësojnë efektet negative të masës. Si pasojë, ka nevojë për kontrolle të rrepta. KPT konsideron se vendosja në izolim administrativ me vetmi duhet të autorizohet vetëm nga anëtari më i lartë i stafit në burg; çfarëdo vendosje e kësaj mase si një emergjencë duhet të raportohet tek anëtari më i lartë i personelit në detyrë menjëherë dhe të silltet në vëmendjen e drejtorit të burgut sa më shpejt që të jetë e mundur. Një raport i plotë i shkruar duhet të hartohet para se anëtari i stafit që merr vendimin të dalë nga detyra. Kjo duhet të regjistrojë arsyet për vendimin dhe kohën e saktë kur ai është miratuar masa si dhe pikëpamjet e të burgosurit për atë sa këto mund të konstatohen. Duhet të ketë monitorim të vazhdueshëm, të regjistruar të të gjitha rasteve për disa orët e para dhe personi duhet të lirohet nga izolimi sapo arsyeja për vendosjen e masës të jetë zgjidhur. Në të gjitha rastet kur masa vazhdon për më shumë se 24 orë, duhet të ketë shqyrtim të plotë të të gjitha aspekteve të çështjes, me synim të tërheqjes së masës në mundësinë më të hershme.

Nëse bëhet e qartë se izolimi ka gjasë të jetë i nevojshëm për një periudhë më të gjatë, duhet të përfshihet një organ i jashtëm për burgun që mban të burgosurin, për shembull, një anëtar i lartë i stafit të selisë. E drejta e ankimit të një autoriteti i pavarur duhet të vihet në vend. Kur të konfirmohet një urdhër, duhet të mbledhet një konferencë e plotë ndërdisiplinore e rastit të ftohet i burgosuri për të bërë përfaqësime të ky organ. Një detyrë e madhe për ekipin shqyrtues është që ta krijojë një plan për të burgosurit me qëllim të adresimit të çështjeve që i kërkojnë të burgosurit të mbahet në izolim. Ndër të tjera, shqyrtimi 1} duhet të shikojë edhe nëse disa nga kufizimet e vendosura mbi të burgosurin janë rreptësisht të nevojshme - kështu mund të jetë e mundur të lejohet njëfarë ndërveprimi i kufizuar me disa të burgosur të tjerë të zgjedhur. I burgosuri duhet të marrë me shkrim një vendim të arsyetuar nga organi shqyrtues dhe një tregues se sa mund të ankohet ndaj vendimit. Pas një vendimi fillestar, duhet të ketë një shqyrtim të mëtejshëm të paktën pas muajit të parë dhe më pastaj së paku çdo tre muaj, në të cilët mund të vlerësohet progresi kundër planit të miratuar dhe nëse është e nevojshme të zhvillohet një plan i ri. Sa më gjatë që një person të mbetet në këtë situatë, më i plotë duhet të jetë shqyrtimi dhe më shumë resurse, duke i përfshirë resurset jashtë burgut, duhet të jenë në dispozicion në përpjekje për ta (ri)integruar të burgosurin në komunitetin kryesor të burgut. I burgosuri duhet të ketë të drejtë të kërkojë një shqyrtim në çdo kohë dhe të marrë raporte të pavarura për një shqyrtim të tillë. Drejtori i burgut ose anëtarët e lartë të stafit duhet të vizitojnë të burgosurit e tillë përditë dhe të njihen me planet individuale. Personeli mjekësor duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë të burgosurve që mbahen në këto kushte.

### **(d) Izolimi për qëllime të mbrojtjes**

Rastet e mbrojtjes me "kërkesa vetjake" ngrenë më pak pyetje sesa ato që urdhërohen për të shkuar në mbrojtje nga stafi, por prapë kanë nevojë për njëfarë konsiderate. KPT-ja konsideron se të gjitha alternativat, duke përfshirë transferimin në një burg tjetër ose të të burgosurit individual që ka nevojë për mbrojtje ose të të burgosurve që shkaktojnë problemin, ndërmjetësimin dhe trajnimin për këmbëngulësi, duhet të provohen fillimisht dhe pasojat e plota të një vendimi për të shkuar në

mbrojtje duhet t'i shpjegohen të burgosurit. Natyrisht, kërkesa nga ndonjë i burgosur në mbrojtje vullnetare për t'u kthyer në kryerrymë duhet të konsiderohet dhe të mundësohet nëse mund të bëhet në mënyrë të sigurt.

Ata që janë vënë në mbrojtje kundër vullnetit duhet të kenë të drejtën për të luajtur rol të plotë në diskutimin e vendimit dhe të ofrojnë zgjidhje alternative. Atyre duhet t'u jepet një shpjegim i plotë i vendimit dhe mundësi për ta sfiduar atë në një nivel më të lartë. Vendimi duhet të shqyrtohet rregullisht në mënyrë që izolimi të mund të përfundojë sa më parë mbasi nuk është më i nevojshëm.

### **Kushtet materiale në izolimin me vetmi**

58. Qelitë e përdorura për izolim duhet të plotësojnë të njëjtat standarde minimale si ato që zbatohen për vendosjen e të burgosurve të tjerë. Prandaj, ato duhet të jenë të një madhësie të përshtatshme, të kenë qasje në dritë natyrore dhe të pajisen me ndriçim artificial (në të dyja rastet të mjaftueshme për të lexuar), dhe të kenë ngrohje të mjaftueshme e ventilim. Ato duhet të jetë e pajisura edhe me një mjet komunikimi me personelin e burgjeve. Rregullimet e duhura duhet të bëhen që të burgosurit të përmbushin nevojat fiziologjike në mënyrë të dinjitetshme në çdo kohë dhe të bëjnë dush të paktën aq sa të burgosurit në regjimin normal. Të burgosurit e mbajtur në izolim duhet të lejohen të veshin rroba normale burgu dhe ushqimi që u ofrohet atyre duhet të jetë menyja normale e burgut, duke përfshirë dietat e veçanta kur kërkohet. Sa për zonën e ushtrimit që përdoret nga të burgosurit e tillë, ajo duhet të jetë mjaft e madh për t'u mundësuar atyre vërtet të ushtrojnë duhet të ketë disa mjete të mbrojtjes nga elementet.

59. Shumë shpesh, delegacionet e KPT gjejnë se një ose më shumë prej këtyre kërkesave themelore nuk përmbushen, veçmas në lidhje me të burgosurit që i nënshtrohen izolimit me vetmi si sanksion disiplinor. Për shembull, qelitë e projektuara për këtë lloj të izolimit ndonjëherë janë të vendosura në zonat e bodrumit, me qasje të pamjaftueshme në dritën natyrore dhe në ventilim dhe me lagështi. Dhe nuk është e pazakontë që qelitë të jenë shumë të vogla, ndonjëherë madje 3 deri në 4m<sup>2</sup>; në lidhje me këtë, KPT dëshiron të theksojë se çdo qeli me përmasa pak se 6m<sup>2</sup> duhet të tërhiqet nga shërbimi si strehim i të burgosurve. Zonat për ushtrime të përdorura nga të burgosurit në fjalë po ashtu janë shpesh të pamjaftueshme.

60. Është praktikë e zakonshme që qelitë e të burgosurve që i nënshtrohen izolimit me vetmi si dënim të kenë një sasi të kufizuar të mobileve, e cila shpesh është e kapur për dyshtemenë. Megjithatë, qelitë e tilla duhet të pajisen, si minimum, me një tavolinë, ulëse të përshtatshme për ditën (pra një karrige ose stol), dhe një krevat të përshtatshëm e mbulojë gjatë natës.

Sa i përket qelive që përdoren për të burgosurit që i nënshtrohen llojeve të tjera të izolimit me vetmi, KPT-ja konsideron se ato duhet të mobilohen në të njëjtën mënyrë si qelitë e përdorura nga të burgosurit në vende normale.

### **Regjimet në izolimet me vetmi**

61. Ashtu si me të gjitha regjimet e tjera të zbatuara për të burgosurit, duhet të ndiqet parimi që të burgosurit e vendosur në izolim duhet t'u nënshtrohen jo më shumë kufizimeve sesa janë të nevojshme për mbajtjen e tyre të sigurt dhe të rregullt. Për më tej, duhet të bëhen përpjekje të veçanta për ta përmirësuar regjimin e atyre që mbahen në izolim afatgjatë, e që kanë nevojë për vëmendje të veçantë për ta minimizuar dëmin që kjo masë mund t'ua sjellë. Nuk ka nevojë për një qasje "të gjitha ose asgjë" ndaj çështjes. Çdo kufizim i caktuar duhet të aplikohet vetëm në mënyrën e duhur për rrezikun e vlerësuar të të burgosurit individual. Njëlloj, siç është treguar tashmë, duhet të ketë diferencim të qartë ndërmjet regjimeve të aplikuara për personat e vënë në izolim me vetmi, duke pasur parasysh llojin e izolimit të përfshirë.

**(a) Të burgosurit e vendosur në izolim si pjesë e kushteve të paraburgimit të urdhëruar nga gjykata** duhet të trajtohen sa më shumë si të burgosurit e tjerë në paraburgim, me kufizime shtesë të aplikuara vetëm siç kërkohet me rigozitet për administrimin e drejtësisë.

**(b) Të burgosurit i nënshtrohen izolimit me vetmi si sanksion disiplinor** nuk duhet të privohen asnjëherë prej kontakteve me familjet e tyre dhe çdo kufizim në kontaktet e tilla duhet të vendoset vetëm kur shkelja ka të bëjë me kontaktet e tilla. Dhe nuk duhet të ketë kufizim në të drejtën e tyre për qasje te avokati. Ata duhet të kenë të drejtë të paktën për një ushtrim jashtë për një orë në ditë, nga dita e parë e vënies në izolim, dhe të inkurajohen për të bërë stërvitje jashtë. Ata duhet gjithashtu të lejohen në një gamë të arsyeshme të materialit të leximit (i cili, për shembull, nuk duhet të kufizohet të tekste fetare). Është mjaft e rëndësishme që ata të kenë njëfarë stimulimi për të ndihmuar në ruajtjen e mirëqenies së tyre mendore.

**(c) Të burgosurit e vendosur në izolim me vetmi administrativ për qëllime parandalimi** duhet të ketë një plan regjimi individual, që synon të adresojë arsyet e masës. Ky plan duhet të përpiqet të maksimizojë kontaktin me të tjerët - stafin fillimisht, por sa më shpejt me të burgosurit e përshtatshëm të tjerë - dhe të ofrojë një sërë aktiviteteve sa më të gjerë për të mbushur ditët. Duhet të ketë inkurajim të fortë nga stafi për të marrë pjesë në aktivitete dhe kontakti me botën e jashtme duhet të lehtësohet. Gjatë periudhës së izolimit administrativ me vetmi, objektivi i përgjithshëm duhet të jetë që të bindet i burgosuri për t'u ripërfshirë me regjimin normal.

**(d) Sa u përket të burgosurve të vendosur në izolim për qëllime të mbrojtjes,** ka një ekuilibër për t'u arritur mes nevojës për të shmangur bërjen e këtij lloji të izolimit shumë tërheqës për të burgosurit nga njëra anë dhe në anën tjetër minimizimit të kufizimeve që vihen mbi personat ndaj të cilëve zbatohet masa. Sigurisht, që në fillim të një periudhe të tillë të izolimit, duhet të ndërmerren hapa për ta riintegruar personin sa më parë; nëse bëhet e qartë se ka nevojë për mbrojtje afatgjatë dhe asnjë masë tjetër nuk është e mundshme, duhet të ndiqet rritja e regjimit. Duhet të bëjë përpjekje të veçanta për të identifikuar të burgosur të tjerë me të cilët i burgosuri në fjalë mund shoqërohet i sigurt si dhe situatat, kur do të ishte e mundshme të nxirret personi nga qelia.

## **Roli i stafit të kujdesit shëndetësor në izolimin me vetmi**

62. Praktikuesit mjekësorë në burgje veprojnë si mjekë personale të të burgosurve prandaj të siguruarit se ka marrëdhënie pozitive mjek-pacient mes tyre është faktor me rëndësi për ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenies së të burgosurve. Praktika e mjekëve të burgut që vërtetojnë nëse një i burgosur është i aftë t'i nënshtrohet izolimit me vetmi si dënim (ose ndonjë lloji tjetër të izolimit të shqiptuar kundër dëshirave të të burgosurit), zor se ka gjasë të promovojë këtë marrëdhënie. Kjo pikë është pranuar në Rekomandimin e Këshillit të Ministrave Rec (2006) 2 mbi Rregullat e ndryshuara të burgjeve; në të vërtetë, rregulla në versionin e mëparshëm të Rregullave obligonte mjekët e burgut të vërtetojnë se të burgosurit janë të aftë t'i nënshtrohen dënimit, tashmë është hequr. KPT konsideron se personeli mjekësor nuk duhet të marrë pjesë asnjëherë në asnjë pjesë të procesit të vendimmarrjes që rezulton në ndonjë lloj të izolimit, përveç kur masa zbatohet për arsye mjekësore.

63. Nga ana tjetër, personeli i kujdesit shëndetësor duhet të jetë shumë i vëmendshëm për gjendjen e të gjithë të burgosurve të vendosur në izolim. Stafi i kujdesit shëndetësor duhet të jetë i informuar për çdo vendosje të tillë dhe duhet t'i vizitojë të burgosurit menjëherë pas vendosjes dhe rregullisht pas kësaj, të paktën një herë në ditë, dhe t'u ofrojë atyre ndihmë të duhur mjekësore dhe trajtim sipas kërkesave. Ata duhet t'i raportojnë drejtorit të burgut kurdoherë që shëndeti i të burgosurit vihet seriozisht në rrezik duke u mbajtur në izolim.

## **Përfundim**

64. Qëllimi i KPT-së në përcaktimin e këtyre standardeve është që të minimizojë përdorimin e izolimit në burgje, jo vetëm për shkak të dëmtimit mendor, somatik dhe social që mund të ketë ai për të burgosurit, por edhe duke pasur parasysh mundësin e shfrytëzimit si metodë të qëllimshme të keqtrajtimit. KPT konsideron se izolimi duhet të vendoset vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, si një masë e fundit dhe për kohën më të shkurtër të mundshme.

Të burgosurit që i nënshtrohen izolimit duhet të akomodohen në kushte të përshtatshme. Për më tej, masa duhet të përfshijnë kufizimet minimale mbi të burgosurit, në përputhje me objektivin e saj dhe sjelljen e të burgosurit, dhe gjithmonë duhet të shoqërohet me përpjekje të fuqishme nga ana e stafit për t'i zgjidhur çështjet të cilat sjellin tek shqiptimi i masës. Më konkretisht, regjimet në izolimin me vetmi duhet të jetë sa më pozitive dhe të drejtohen për adresimin e faktorëve që e kanë bërë masën e nevojshme. Përveç kësaj, edhe mbrojtja ligjore dhe praktike duhet të futen në proceset e vendimmarrjes në lidhje me vendosjen dhe rishikimit të izolimit me vetmi.

Të siguruarit se izolimi është gjithmonë përgjigje proporcionale ndaj situatave të vështira në burgje do të promovojë ndërveprimin pozitiv staf-të burgosur dhe do të kufizojë dëmin e bërë ndaj vetë personave që shpesh tashmë janë në mesin e anëtarëve më të cenuar të popullatës së burgosur.